

RAPORTI I NDËRMJETËM PASZGJEDHOR*
29 qershor–7 korrik 2009

10 korrik 2009

I. PËRMBLEDHJE

- Në vijim të Deklaratës së Konstatimeve dhe Konkluzioneve Paraprake të 29 qershorit, Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR-it ka vazhduar vëzhgimin e procesit zgjedhor, duke u përqendruar te numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve.
- Vëzhguesit ndërkombëtarë të MVZ-së ndoqën numërimin në të 66 Vendet e Numërimit të Votave (VNV). Ata vlerësuan se numërimi u krye keq ose shumë keq në 22 VNV.
- Numërimi i votave u zvarrit dhe u karakterizua nga nivele të larta mosbesimi mes partive politike dhe përfaqësuesve të tyre në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Vonesat në numërim provokuan tension mes partive, sidomos aty ku rezultatet ishin ose dukej sikur ishin të afërta. Në disa raste, numërimi i votave u bllokua përkohësisht. Ndërhyrjet e vëzhguesve të partive dhe kandidatëve në procesin e numërimit krijuan shpesh shpërqendrim nga procesi.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) zgjodhi shpesh të mos ndërhyjë në rastet kur në VNV kishte probleme.
- Njëri nga problemet kryesore që u vunë re gjatë numërimit ishin mosmarrëveshjet nëse duheshin numëruar ose jo votat nga disa qendra votimi. Në disa VNV nuk u numëruan të gjitha kutitë e votimit, duke mos u përfshirë në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve.
- Miratimi nga KQZ-ja i Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për 12 zonat zgjedhore shkaktoi shumë debate, me mosmarrëveshje të përsëritura për faktin nëse në këtë fazë KQZ-ja duhet të numëronte e të përfshinte në rezultat kutitë e votimit që nuk ishin përfshirë në tabela nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ). Anëtarët e KQZ-së të propozuar nga shumica parlamentare shkëmbyen akuza të ndërsjella me anëtarët e propozuar nga opozita. Gjatë periudhës së raportimit, tetë nga dymbëdhjetë Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve u miratuan me votat kundër të anëtarëve të propozuar nga opozita.
- Sistemi i ri elektronik i monitorimit, sipas të cilit secila votë duhet të vendosej para videokamerës që vëzhguesit të shihnin se për cilën parti ishte vendosur shenja, duket se nuk e ka rritur shumë transparencën e procesit. Në mënyrë të veçantë, nuk ishte gjithmonë e mundur të shikohej se për cilin subjekt ishte votuar apo nëse votat vendoseshin në stivën e votave të partisë së duhur.
- Deri tani, në KQZ janë bërë 16 ankimime kundër Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve nga Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) në qarkun e Tiranës dhe Durrësit. Ankimimet u pezulluan, për t'u ribërë dhe për t'u shqyrtuar pas miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zonën zgjedhore përkatëse nga KQZ-ja.

* I vetmi version zyrtar i këtij dokumenti është ai në gjuhën angleze.

- Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it do të vazhdojë të ketë një grup të vogël ekspertësh për të ndjekur fazat e papërfunduara të procesit zgjedhor, në veçanti shqyrtimin e ankesave dhe kërkesëpadive.

II. HYRJE

Më 29 qershor, Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ), një nismë e përbashkët e OSBE/ODIHR-it, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe Asamblesë Parlamentare të NATO-s, nxorën një Deklaratë të Konstatimeve dhe Konkluzioneve Paraprake, ku pasqyruan zhvillimet e periudhës parazgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve. Deklarata paraprake e MNVZ-së doli në përfundimin se zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit në Shqipëri shënuan progres të dukshëm në lidhje me proceset e regjistrimit dhe identifikimit të zgjedhësve, që më parë ishin çështje problematike, si dhe me kuadrin ligjor, i miratuar me konsensusin e dy partive kryesore. Megjithatë, këto përmirësime u zbehën nga politizimi i anëve teknike të procesit nga partitë politike dhe shkeljet e vërejtura gjatë fushatës zgjedhore, që e ulën besimin e publikut te procesi zgjedhor. MNVZ-ja deklaroi se vlerësimi përfundimtar do të varej në një masë të madhe nga numërimi dhe nxjerrja e rezultateve, si dhe procesi i ankimimit, që janë elemente thelbësore të procesit zgjedhor.

Në vijim, Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it ka vazhduar veprimtaritë e vëzhgimit, duke u përqendruar te numërimi i votave, nxjerrja e rezultateve në nivel të Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) dhe në nivel kombëtar, si dhe te shpallja e rezultateve.

III. SITUATA POLITIKE

Pas votimeve më 28 qershor, procesi i numërimit të votave vazhdoi ngadalë dhe u vonua më tej si pasojë e mosmarrëveshjeve në disa qarqe. Procesu u bë më i ngadaltë nga nivelet e larta të mosbesimit mes partive politike dhe përfaqësuesve të tyre në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Vonesat shkaktuan rritje të tensionit mes partive në ditët pas zgjedhjeve, sidomos për shkak të afërsisë në rezultate. Shpallja e fitores nga Partia Demokratike (PD) para përfundimit të numërimit të votave dhe festimet e mbështetësve të saj u kundërshtuan nga Partia Socialiste (PS). Tension pati sidomos në vendet ku numërimi u vonua më tepër, siç ishin qarqet e Fierit, Shkodrës dhe Tiranës. Më 4 korrik, kreu i Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), Ilir Meta, reagoi pozitivisht ndaj një ftese të Kryeministrit dhe kreut të PD-së, Sali Berisha, për t'iu bashkuar PD-së në qeverisje. Një konventë e jashtëzakonshme kombëtare e LSI-së më 7 korrik e mbështeti vendimin z. Meta.

IV. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Numërimi i Votave dhe Nxjerrja e Rezultateve në Nivel KZAZ-sh

Pas mbylljes së votimit, kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e rëndësishme zgjedhore u transportuan nga Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) në 66 Vendet e Numërimit të Votave (VNV), një për çdo ZAZ. Vëzhguesit e MNVZ-së e ndoqën marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore dhe numërimin e votave në të gjitha VNV-të. Procedurat nga të gjitha VNV-të transmetoheshin në kohë reale në KQZ, nga ku mund të monitoroheshin në ekrane të mëdhenj. Përveç kësaj, kanalet kryesore televizive bënë një pasqyrim të konsiderueshëm të numërimit.

Administrata e KQZ-së ngriti një sistem që lejonte transmetimin elektronik të rezultateve nga VNV-të në KQZ në kohë reale, teksa procesoheshin rezultatet nga secila qendër votimi. Rezultate të pjesshme paraprake, që përditësoheshin vazhdimisht, vendoseshin në faqen e internetit të KQZ-së dhe shfaqeshin në ekrane të mëdhenj në KQZ. Përveç raportimit nga KQZ-

ja, dy OJQ vendase, Election to Conduct Agency (ECA) dhe KRIIK-Albania, i bënë publike rezultatet në projektin e tyre paralel për shpalljen e rezultateve, i cili bazohej te të dhënat që KZAZ-të dërgonin në KQZ.

Çdo VNV kishte nga pesë deri në dhjetë tavolina numërimi, me dy Grupe Numërimi (GNV) për çdo tavolinë, të cilët punonin me turne. Për të siguruar ekuilibrin politik, GNV-të përbëheshin nga dy anëtarë të emëruar nga shumica parlamentare dhe dy anëtarë të emëruar nga opozita. Megjithatë secili GNV, sipas rregullit, duhet të numëronte pesë deri në dhjetë kuti votimi para se të ndërrohej, në realitet GNV-të shpesh nuk zëvendësoheshin, çka shkaktonte edhe më shumë vështirësi për anëtarët e GNV-ve.

Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan marrjen në dorëzim të materia leve zgjedhore si shumë të mirë ose të mirë në 90% të VNV-ve. Megjithatë, ata vunë re se procesi ishte i ngadaltë në disa VNV, sidomos në qytetet e mëdha, ku KQV-të duhet të prisnin për një kohë të gjatë derisa të procesoheshin.

Vëzhguesit e MNVZ-së ndoqën numërimin e votave në të 66 VNV-të duke filluar nga mbrëmja e 28 qershorit dhe në pothuajse të gjitha VNV-të deri në përfundimin e tij, duke raportuar konstatimet e tyre në intervale të rregullta. Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan negativisht numërimin e votave në 22 nga 66 VNV-të. Ata vunë re probleme procedurale, disa prej të cilave dukej se shkaktoheshin nga mungesa e udhëzimeve dhe trajnimit të nevojshëm. Sipas raporteve të tyre, respektimi i procedurave të numërimit ishte i dobët në nëntë VNV (14%). Anëtarët e GNV-ve e kuptonin mirë procesin në 54 VNV, (82%) por nuk vepruan mirë në 14 VNV (21%). Veprimtari e keqe ose shumë e keqe e KZAZ-ve u raportua nga 11 VNV (17%). Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 62 VNV (94%), një ose më shumë GNV patën vështirësi në plotësimin e tabelave të rezultateve të qendrës së votimit.

Numërimi i votave pati një fillim të ngadaltë, pjesërisht për shkak të faktit se shumë nga anëtarët e Grupeve të Numërimit u caktuan vonë dhe nuk ishin trajnuar siç duhet. Më pas procesi u përshpejtua dhe numërimi vazhdoi më normalisht. Asnjë KZAZ nuk arriti ta përfundojë numërimin e votave për ZAZ-në përkatëse para afatit ligjor, pra orës 17:00 të 29 qershorit. Nga mbrëmja e 29 qershorit, numërimi u ngadalësua përsëri, pjesërisht për shkak të lodhjes së KZAZ-së dhe anëtarëve të grupeve të numërimit.

Megjithatë, në këtë pikë, kur rezultatet e pjeshme paraprake tregonin se diferencat ishin të vogla, partitë politike filluan të ndërhyenin më shumë në procesin e numërimit. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan ndërhyrje në procesin zgjedhor në 28 VNV. Si rezultat, procesi u ngadalësua në disa VNV, sidomos në qarqet ku shpërndarja e mandateve ishte ose dukej si gati e barabartë. Në disa raste, KZAZ-të e patën të vështirë të kontrollonin procesin në VNV. Vëzhguesit e MNVZ-së panë vëzhgues të partive që ushtronin presion mbi KZAZ-në dhe GNV-të dhe ndërhyenin në proces. Ata gjithashtu vërejtën se prania e kandidatëve brenda VNV-ve shkaktonte shpërqendrim në proces. Në 33% të raporteve, vëzhguesit e MNVZ-së shënuan se persona të paautorizuar ishin të pranishëm brenda VNV-së. Në Krujë, (VNV 11), situata ishte e tensionuar dhe në një rast u desh të thërritej policia për të rivendosur rregullin. Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re tension ose shqetësim në 45 VNV.

Njëri nga problemet kryesore që u vunë re gjatë numërimit ishin mosmarrëveshjet nëse duheshin numëruar ose jo disa kuti votimi nga disa qendra votimi. Kodi Zgjedhor parashikonte procedurat sipas të cilave KZAZ-ja mund ta deklarojë një kuti votimi si “të parregullt” vetëm pas dorëzimit

nga KQV-ja, në rast se është ose mund të jetë cënuar¹. Nëse vërehen pasaktësi ose parregullsi gjatë verifikimit të materialit zgjedhor ose numërimit të votave, KZAZ-ja duhet të marrë vendim në lidhje me këtë çështje. Pas shënimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimeve të KZAZ-së, KZAZ-ja merr “vendim për vazhdimin e procedurale të numërimit të votave” (Neni 116.6 i Kodit Zgjedhor). Nuk ka dispozita sipas të cilave KZAZ-ja ose GNV-ja mund ta deklarojë të parregullt apo të pavlefshme kutinë e votimit pasi ka filluar numërimi.

Megjithatë, në praktikë, kjo u interpretua sikur KZAZ-ja kishte autoritetin të ndërpriste numërimin e një kutie votimi ose të mos ta përfshinte atë në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në. Pati raste kur kuti të tilla nuk u numëruan. Për shembull, gjashtë kuti votimi në ZAZ-në 39 (Laç, qarku i Lezhës), nuk u numëruan për shkak të mungesës së numrave të dokumenteve të identifikimit në listën e zgjedhësve². KZAZ-ja nuk plotësoi Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve e as nuk mori vendim për të.

Raste të tjera ku nuk u numëruan të gjitha kutitë e votimit pati në dy qendra votimi në ZAZ-në 11 (Krujë, qarku Durrës), shtatë në qarkun e Korçës (ZAZ-të 29, 30, 31 dhe 32), si edhe një në Berat (ZAZ 2). Megjithatë, në këto raste, KZAZ-të e plotësuan Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve dhe ia dërguan atë KQZ-së. Në ZAZ-në 30 në Qarkun Korçë, kryetari i KZAZ-së i dërgoi rezultatet e pesë qendrave të votimit në KQZ vetëm pasi u pyet nga vëzhguesit e MNVZ-së se cila ishte arsyeja për mosdërgimin e tyre. Po ashtu, kryetari i KZAZ-së vendosi që të mos numërohej kutia e fundit e votimit duke u shprehur se rezultati në VNV ishte “tepër afër” dhe se ai nuk mund të merrte përsipër përgjegjësinë e të numëruarit.

Në ZAZ-në 37 (qyteti i Lezhës), KZAZ-ja e dominuar nga PS-ja vendosi të mos i përfshinte rezultatet e 11 qendrave të votimit në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve. Anëtarët e KZAZ-së të emëruar nga shumica qeverisëse dërguan një Tabelë të veçantë Përmbledhëse të Rezultateve, në të cilën përfshiheshin të gjitha qendrat e votimit në ZAZ, një tabelë e cila nuk ishte nënshkruar nga shumica e anëtarëve të KZAZ-së.

Në VNV-në 41 në Bushat (qarku Shkodër), anëtarët e emëruar nga opozita në KZAZ bllokuan procesin, duke mos u numëruar asnjë votë nga ora 14:00 më 30 qershor deri në orën 12:00 më 1 korrik. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari i KZAZ-së i emëruar nga PS-ja u zëvendësua dy herë, në marrëveshje me anëtarët e emëruar nga PS-ja në KQZ dhe përfaqësuesin e Partisë Socialiste në KQZ. Kur u bë e qartë se 42 kutitë e panumëruara nga Bushati nuk do të kishin ndikim në caktimin e mandateve, numërimi rifilloi dhe përfundoi pa probleme. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se mungesa e numrave të kartave të identitetit, e cila kishte qenë arsyeja kryesore për refuzimin e numërimit të kutive të votimit më parë, u duk se nuk përbënte më problem.

Në VNV-në 5 (Peshkopi, qarku Dibër), numërimi u bllokua përkohësisht pas kërkesës së anëtarëve të emëruar nga PD-ja në Grupin e Numërimit të Votave (GNV) për të parë diplomat e shkollës së mesme të anëtarëve të emëruar në GNV nga PS-ja, duke vënë në pikëpyetje nëse ata ishin të përshatshëm ose jo për të qenë anëtarë të GNV-së.

Problemet më serioze në lidhje me numërimin e votave u vërejtën në qarkun e Fierit. Përveç tre qendrave të votimit që nuk u hapën fare ditën e votimit³, në Tabelën Përmbledhëse të

¹ Sipas KQZ-së, dy kuti votimi u deklaruan të parregullta në ZAZ-në 13, (qarku Elbasan) dhe ZAZ-në 38 (qarku Lezhë)

² Sipas Kodit Zgjedhor, në kohën kur i jep fletën e votimit zgjedhësit, kryetari i KQV-së duhet të shkruajë në listën e votimit numrin e dokumentit të identifikimit të secilit zgjedhës. Në disa qendra votimi, kjo procedurë nuk u zbatua fare; në disa raste, mungonin disa numra të dokumenteve të identifikimit.

³ KQZ-ja ende nuk i ka dhënë MVZ-së së OSBE/ODIHR-it arsyen apo shpjegimin zyrtar se përse nuk u hapën këto qendra votimi.

Rezultateve nuk u përfshinë rezultatet e nëntë qendrave të votimit. Në fakt, votat e pesë prej këtyre qendrave u numëruan, por shumica e anëtarëve të KZAZ-ve 18 dhe 20 nuk ranë dakord t'i përfshinin ato në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve. Në ZAZ-në 20, jashtë VNV-së u mblodhën politikanë të njohur të PS-së si edhe mbështetës të kësaj partie, të cilët kërkuan që kutitë e kontestuara të përfshiheshin në tabelën e rezultateve. Situata e tensionuar u qetësua dhe turma u shpërnda pas disa orësh. Pas bllokadës u arrestuan katër protestues, tre prej të cilëve u liruan shpejt. Arsyet kryesore për problemet që u dëshmuuan në Fier, ishin rezultatet e zgjedhjeve, me një mandat që lëkundej mes koalicionit të udhëhequr nga PD-ja dhe atij të udhëhequr nga PS-ja. Votat e hedhura në qendrat e votimit por që nuk ishin përfshirë në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve mund të përcaktonin shpërndarjen e mandateve në qarkun e Fierit.

Fatkeqësisht, kur u vërejtën apo u raportuan probleme në VNV, KQZ-ja zgjodhi shpesh të mos ndërhynte pavarësisht faktit se ndodhej në një pozitë të tillë ku mund të monitoronte atë që po ndodhte në VNV. Debatet në KQZ, që lindën si pasojë e udhëzimeve të pamjaftueshme për KZAZ-të dhe GNV-të, si edhe për pasojë të mosveprimit në ato vende ku pati probleme, kishin të bënin me kohën dhe mënyrën e duhur për të zgjidhur këto probleme, në veçanti në lidhje me kutitë e panumëruara të votimit.

Sipas sistemit të ri të monitorimit elektronik, çdo fletë votimi vendosej përpara video-kamerës dhe u tregohej vëzhguesve në ekrane të mëdhenj disa metra larg tavolinës së numërimit. Ky sistem duket se kontribuoi vetëm pjesërisht për transparencën e procesit dhe nuk zgjidhi disa nga problemet e ndërhyrjeve të vërejtura në zgjedhjet e mëparshme. Edhe pse fletët e votimit shfaqeshin në ekrane të mëdhenj, nuk ishte gjithnjë e mundur të dallohej se për cilën parti ishte bërë shënimi në to. Ishte gjithashtu e pamundur për vëzhguesit që të shikonin nëse fletët e votimit vendoseshin në stivën e duhur, kështu që partitë e vogla aluduan se votat e tyre ishin vendosur në stivat e dy partive më të mëdha.

Hartimi i Tabelave Përmbledhëse dhe Shpallja e Rezultateve nga KQZ

Pas marrjes së Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve nga KZAZ-të, KQZ nxjerr tabelën e rezultateve për secilën nga 12 zonat zgjedhore. Vendimi përkatës i KQZ-së, i cili kërkoi një shumicë të thjeshtë, duhet të merret brenda dy ditësh nga marrja e Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve nga secila zonë. Ky afat nuk u respektua në të gjitha rastet. Si fazë përfundimtare, KQZ-ja duhet të bëjë shpërndarjen e mandateve për secilën zonë zgjedhore brenda 3 ditësh pas përfundimit të procesit të ankimit, me një shumicë të cilësuar prej 5 votash.

Miratimi i Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve nga KQZ-ja shkaktoi shumë debate. Anëtarët e emëruar nga opozita dhe përfaqësuesit e PS-së në KQZ kërkuan që KQZ-ja të numëronte dhe të përfshinte në Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të KZAZ-ve përkatëse të gjitha kutitë e votimit që nuk ishin përfshirë nga KZAZ-të. Mazhoranca e KQZ-së argumentoi se nëse ekziston një Tabelë Përmbledhëse Rezultatesh, ajo duhet të shërbejë si bazë për Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për një zonë zgjedhore dhe se në kësi rastesh Kodi Zgjedhor nuk lejon që KQZ-ja të marrë rolin e KZAZ-së, siç parashikohet nga Neni 35.5 në raste kur KZAZ-ja nuk arrin dot të marrë një vendim brenda afateve ligjore. Shumica gjithashtu theksoi se fletët e votimit do të duhej gjithsesi të numëroheshin ose të rivlerësoheshin me kërkesë të dy anëtarëve të KQZ-së nëse bëhej ankimi kundër Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të një zone zgjedhore. Gjatë periudhës së raportimit, KQZ-ja miratoi tetë Tabela Përmbledhëse të Rezultateve nga 12 që janë gjithsej, megjithë votat kundër të anëtarëve të emëruar nga opozita.

Në rastin e Laçit (ZAZ 39), KQZ-ja vendosi të numëronte gjashtë kutitë e votimit që nuk ishin numëruar nga ZAZ-ja 39 dhe të miratonte Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për këtë ZAZ, duke qenë se KZAZ-ja nuk e kishte miratuar, në të cilën përfshiheshin edhe gjashtë kutitë e

votimit që nuk u numëruan nga KQZ-ja,. Në rastin e ZAZ-së 37 (qyteti i Lezhës), KQZ vendosi të përdorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve e cila përfshinte të gjitha qendrat e votimit, por nuk ishte nënshkruar nga shumica e KZAZ-së. KQZ-ja vendosi të merrte parasysh këtë tabelë, meqenëse të dhënat mbështeteshin nga tabelat origjinale të rezultateve të qendrave të votimit për të 11 qendrat në fjalë. Gjatë periudhës së raportimit, KQZ-ja nuk e miratoi Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për zonën zgjedhore të Lezhës

Mbledhjet e KQZ gjatë të cilave u miratuan Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve u karakterizuan nga mosbesimi, tensioni dhe fjalët e ashpra. Pas shumë diskutimesh, cdo tabelë miratohej me katër votat e anëtarëve të caktuar nga shumica parlamentare, ndërsa anëtarët e caktuar nga opozita votonin kundër. Debatet në lidhje me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për qarkun e Fierit ishin shumë të ashpra, për shkak të ndikimit të mundshëm të votave të panumëruara në ndarjen e mandateve të kësaj zone zgjedhore dhe kërcënimeve të PS-së se nuk do t'i njohë rezultatet e zgjedhjeve nëse nuk do të numërohen dhe përfshihen në rezultat të gjitha kutitë e votimit të Fierit. Pas diskutimesh të tejzgjatura, gjatë të cilave anëtarët e KQZ-së të emëruar nga shumica dhe ata nga opozita akuzuan njëri-tjetrin se po përpiqeshin të dëmtonin procesin zgjedhor, nuk u arrit asnjë kompromis dhe tabelat e rezultateve u miratuan me katër vota pro. Një kërkesë e bërë nga përfaqësuesi i PS-së që të përfshiheshin në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve dy qendrat e votimit të ZAZ-së 20, që ishin numëruar por nuk ishin përfshirë, u hodh poshtë nga shumica e KQZ-së. Kryetari i PS-së Edi Rama paralajmëroi se në rast se procesi i numërimit në Fier nuk do të përfundonte në mënyrë të kënaqshme, atëherë PS-ja do fillonte protestat në rrugë.

V. ANKESAT DHE KËRKESËPADITË

Kodi Zgjedhor përcakton që çdo subjekt zgjedhor (parti politike ose koalicion që garon në zgjedhje, ose kandidat i propozuar nga zgjedhësit) ka të drejtën të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, në rast se “vendimi i KZAZ-së çënon interesat e tyre të ligjshme”. Kodi përcakton gjithashtu se çdo vendim i marrë nga KZAZ-ja gjatë marrë në dorëzim të materialit zgjedhor dhe dokumentacionit nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së tabelave të rezultateve janë vendime afatshkurtra dhe mund të ankimohen në KQZ, bashkë me ankimin ndaj vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të zonës zgjedhore.

Sidoqoftë, gjatë periudhës së raportimit, në KQZ u bënë 16 ankime të vendimeve të disa KZAZ-ve në Tiranë dhe Durrës për Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve, në një kohë kur Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-ve përkatëse nuk ishte miratuar ende nga KQZ-ja. Një kërkesë ankimore u bë nga Partia Republikane, një tjetër nga një vëzhgues i akredituar i PD-së, katër nga një kandidat i Partisë Konservatore të Shqipërisë dhe dhjetë nga Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Më vonë, PD-ja e tërhoqi ankesën e saj.

Deri tani, KQZ-ja i ka trajtuar kërkesat ankimore në mënyrë jo gjithmonë të njëllojtë. Ndërsa dy nga kërkesat ankimore të kandidatit të Partisë Konservatore u hodhën poshtë mbi baza procedurale, (Kodi Zgjedhor nuk u jep kandidatëve të veçantë të drejtën e ankimit, përveç rasteve kur janë kandidatë të propozuar nga një grup votuesish), dy të tjerat iu kthyen dërguesit të kërkesës ankimore për korrigjim, duke qenë se vendimi i kontestuar i KZAZ-së nuk ishte i bashkangjitur. Edhe pjesa më e madhe e kërkesave të tjera ankimore u kthye për korrigjim. Pas korrigjimit, ato u pezulluan për t'u bërë edhe njëherë nga fillimi dhe për t'u rishikuar në një fazë të mëvonshme, pas miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zonën Zgjedhore.

Përveç marrjes së vendimit për kërkesat ankimore kundër Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të zonave zgjedhore, KQZ-ja vendos gjithashtu për kërkesat e bëra nga subjektet zgjedhore ose për nismat e vetë KQZ-së për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet në qendra të caktuara të

votimit, si dhe për kërkesat për të shpallur të pavlefshme e për të përsëritur zgjedhjet në të gjithë territorin e një zone zgjedhore, në rast se shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi ndikon në shpërndarjen e mandateve në zonën përkatëse zgjedhore. Të gjitha vendimet e KQZ-së mund të ankimohen nga subjektet zgjedhore në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditësh. Kolegji Zgjedhor duhet ta shqyrtojë kërkesëpadinë brenda dhjetë ditësh.

VI. VEPRIMTARITË E MVZ-SË SË OSBE/ODIHR-IT

Gjatë periudhës së raportimit, vëzhguesit afatshkurtër dhe afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e përfunduan misionin e tyre. Ekipi Bazë vazhdoi veprimtaritë dhe takimet. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it do të vazhdojë të ketë të pranishëm një grup ekspertësh, për të vijuar vëzhgimin e fazave të papërfunduara të procesit zgjedhor, në mënyrë të veçantë shqyrtimin e ankesave dhe kërkesëpadive nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Kolegji Zgjedhor.